



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT



Ë-buletin

Qershor, 2018

SBASHK informon Ministrin Bytyqi për kundërshtimet e bazuara ndaj Projektligjit të pagave

Arsimi duhet të ketë vend të merituar në këtë Projektligj



Edhe në kohën e Qeverisë Mustafa po Ministri Yagcilar dhe stafi i tij kishin përgatitur një version të projektligjit për pagat, që e kishin shoqëruar me një tabelar me gradime e koeficiente. SBASHK-u e kishte analizuar këtë version dhe kishte reaguar me kohë duke paralajmëruar institucionet se nëse Projektligji mbetet i tillë dhe shkon në Parlament atëherë SBASHK-u do të organizojë veprime sindikale duke shpallur grevë në të gjitha institucionet arsimore. Qeveria Mustafa ... (faqe 5)

Për projektligjin për pagat takim edhe me Ministrin Yagcilar

SBASHK kundërshton me argumente dhe paralajmëron veprime sindikale



Pasi që janë takuar me Ministrin Bytyqi dhe i kanë shprehur pakënaqësinë dhe kundërshtimin ... (faqe 6)

SBASHK i trajnon udhëheqësit e sindikatave komunale për udhëheqje në arsim



SBASHK vazhdon me aktivitetet në shërbim të arritjes së njohurive të reja ... (faqe 5)

Intervista të shkurtra me disa prej anëtarëve të komisionit për pushime

Ndjehemi mirë që pushuesit u kthyen me përshtypje shumë të mira për pushimet

Në shenjë respekti për përkushtimin, punën dhe angazhimin që kanë bërë me qëllim që pushimet të kenë rrjedhë të mirë dhe të jenë sa më ... (faqe 3-4)

Vazhdon bashkëpunimi i suksesshëm i SBASHK-ut me GIZ-in

Organizim i suksesshëm i Konferencës së katërt të matematikës



Edhe me Konferencën e katërt të matematikës, organizuar në bashkëpunim me GIZ-in, SBASHK-u ka dëshmuar përkushtimin... (faqe 7)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Na presin shumë sfida



U përmbyll edhe një vit shkollor i përcjellë me mjaft sfida. Janë

bërë gjatë gjithë kohës përpjekje, takime, promovime e aktivitete për një arsim edhe më të mirë. Janë mbajtur edhe shumë takime, kishte edhe greva dhe u shënuan edhe arritje. Tani janë pushimet dhe më shumë se 420 anëtarë të SBASHK-ut u shoqëruan në pushimet e organizuara mirë nga sindikata e me valët e detit shqiptar.

Koha kërkon që të pushohet edhe sa dhe të mblidhen forca të reja sepse na presin mjaft sfida edhe në vitin shkollor që po vjen. Besojmë se deputetët do ta votojnë edhe pas leximit të dytë Projektligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës, ashtu siç vepruan pas leximit të parë dhe ky do të jetë një sukses i madh i të gjithëve.

Një sfidë tjetër është edhe Projektligji i pagave . SBASHK-u kishte reaguar edhe në kohën e

Qeverisë Mustafa me plot argumente kundër projektligjit atëherë. Ka reaguar dhe vazhdon me angazhimet edhe tani sepse Ministria e Administratës Publike në tabelarin e rangimeve e ka lënë në pozitë të ulët sektorin e arsimit. SBASHK-u ka ofruar versionin e vetë të mbështetur me fakte e argumente dhe i ka bërë me dije Ministrave Yagcilar e Bytyqi se nëse nuk përfilllet rastësisht propozimi i SBASHK-ut , atëherë shtatorin shkollat do ta nisin me greva.

SBASHK-u ka alarmuar me kohë Ministrin Bytyqi edhe lidhur me Udhëzimin Administrativ 06/2015 duke kërkuar që të shfuqizohet neni 12 dhe t'u krijohen kushte kolegëve tanë në shkollat e mesme që në Fakultetin e Edukimit të ndjekin ligjëratat e duhura dhe të marrin njohuri të reja dhe titullin master.

Na presin shumë sfida, por ato do t'i tejkalojmë me unitet dhe bashkë e në SBASHK.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë , mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës(SBASHK) përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Intervista

Intervista të shkurtra me disa prej anëtarëve të komisionit për pushime

Ndjehemi mirë që pushuesit u kthyen me përshtypje shumë të mira për pushimet

Në shenjë respekti për përkushtimin, punën dhe angazhimin që kanë bërë me



qëllim që pushimet të kenë rrjedhë të mirë dhe të jenë sa më relaksuese në këtë numër të gazetës sonë “Arsimimi sot” në rubrikën “Intervista” do të sjellim përgjigjet e disa prej anëtarëve të komisionit të pushimeve lidhur me përshtypjet e tyre nga kjo veprimtari në shërbim të anëtarëve të SBASHK-ut.

Ymer Ymeri: Ishte kryetar i komisionit për organizimin dhe mirëvajtjen e pushimeve.

“ Njeriu e harron lodhjen që ka pasur gjatë gjithë aktivitetit të përgatitjes së pushimeve dhe përkushtimin e vazhdueshëm gjatë gjithë ditëve të pushimit kur shoh se kolegët tanë, anëtarë të SBASHK-ut nga e tërë Kosova janë ndjerë mirë dhe vlerësojnë lartë organizimin e këtij aktiviteti, por edhe gjithë angazhimet dhe arritjet e SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë. Ndjehemi krenar nga falënderimet dhe vlerësimet e mira që na kanë bërë pushuesit”.

Afërdita Ahmeti- Ishte anëtare e komisionit e angazhuar me grupin e parë të pushuesve.

“ Kam pasur pak stres në fillimet e këtyre pushimeve me grupin e parë, por kjo kaloi shpejt pasi që të gjithë pushuesit kishin qëndrim të dinjitetshëm dhe krijuan një atmosferë vërtetë relaksuese dhe festive. Përveç plazhit ata krijuan momente të bukura përmes bashkëbisedave duke kujtuar kohët e shkuara, por edhe duke folur për sfidat e shumta të profesionit prej mësimdhënësit”.

Blendor Shatri- po ashtu anëtar i komisionit i angazhuar me grupin e parë të pushuesve.


“Vërtetë është kënaqësi të angazhohesh për njerëz të tillë. Ata prezantuan në bregdetin shqiptar në mënyrën më të mirë SBASHK-un dhe figurën e mësuesit të

Kosovës. Koha ka ikur shumë shpejtë dhe pushuesit kanë pasur vazhdimisht fjalë të mira për SBASHK-un, për angazhimin tonë si komision, por edhe për kushtet në “Bonita” dhe për stafin e këtij Kompleksi hotelier”.

Nezafete Jakupi- anëtare e komisionit e angazhuar me grupin e tretë të pushuesve.

“Isha e angazhuar në cilësinë e anëtares së komisionit për mirëvajtjen e pushimit që nga koha kur filluan përgatitjet e para për këtë aktivitet. Kalova momente të paharruara buzë valëve të detit shqiptar me pushuesit e grupit të tretë. Ky grup me sjellje të dinjitetshme ka bërë që ruhen përshtypjet e mira për SBASHK-un. Ata do të ruajë për një kohë të gjatë kujtimet nga ditët e pushimeve në ambientet e mrekullueshme të Kompleksit Hotelier “Bonita”. Shumë nga ata i kanë vënë në letër përshtypjet e tyre përmes të cilave shprehin gëzimin për ditët e kaluar këtu dhe falënderimin për angazhimin dhe përkushtimin e SBASHK-ut”.

Disa nga përshtypjet e pushuesve të tre grupeve janë publikuar më poshtë.



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Shënime
26.06.2018
Shënime nga punimet...
...koncepte të reja...
...koncepte të reja...
...koncepte të reja...

DEKLARIM
Falënderojmë Komitetin...
...koncepte të reja...
...koncepte të reja...
...koncepte të reja...

Shënime
...koncepte të reja...
...koncepte të reja...
...koncepte të reja...

Shënime
...koncepte të reja...
...koncepte të reja...
...koncepte të reja...

Shënime
...koncepte të reja...
...koncepte të reja...
...koncepte të reja...

Shënime
...koncepte të reja...
...koncepte të reja...
...koncepte të reja...

Shënime
...koncepte të reja...
...koncepte të reja...
...koncepte të reja...

Shënime
...koncepte të reja...
...koncepte të reja...
...koncepte të reja...

Shënime
...koncepte të reja...
...koncepte të reja...
...koncepte të reja...

Shënime
...koncepte të reja...
...koncepte të reja...
...koncepte të reja...

Shënime
...koncepte të reja...
...koncepte të reja...
...koncepte të reja...

Redaksia e gazetës sonë “Arsimimi sot” është e sigurt se edhe anëtarët e komisionit Rrezarta Bahtijari, Halime Rama, Marigonë Bytyqi, Bahrie Ismaili, Shqipe Kastrati e Sefedin Berisha janë kthyer nga detyra e besuar me plot kujtime, emocione dhe se janë ndier krenar që për ato ditë të pushimit kanë dhënë kontribut që kolegët e tyre të ndjehen sa më mirë dhe të kënaqen me gjithë ato që ofrojnë ambientet e Kompleksit Hotelier “Bonita” dhe bukuria përrallore e bregdetit shqiptar.

Falënderojmë në emër të gjithë pushuesve dhe anëtarëve të komisionit për mirëvajtjen e pushimeve pronarin dhe stafin e Kompleksit Hotelier “Bonita” me urimet më të mira për ta U TAKOFSHIM PRAPË E ME GËZIME .



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Gjatë muajit

SBASHK informon Ministrin Bytyqi për kundërshtimet e bazuara ndaj Projektligjit të pagave Arsimi duhet të ketë vend të merituar në këtë Projektligj



Edhe në kohën e Qeverisë Mustafa po Ministri Yagcilar dhe stafi i tij kishin përgatitur një version të projektligjit për pagat, që e kishin shoqëruar me një tabelar me gradime e koeficiente. SBASHK-u e kishte analizuar këtë version dhe kishte reaguar me kohë duke paralajmëruar institucionet se nëse Projektligji mbetet i tillë dhe shkon në Parlament atëherë SBASHK-u do të organizojë veprime sindikale duke shpallur grevë në të gjitha institucionet arsimore. Qeveria Mustafa e kishte kuptuar seriozisht këtë alarm dhe prandaj e kishte stopuar Projektligjin duke pritur ditë e momente më të mira.

Ky projektligj u ri aktualizua dhe po Ministri Yagcilar me stafin e tij e kishin ripunuar Projektligjin e pagave duke bërë për sektorin e arsimit vetëm ndryshime kozmetike. SBASHK-u reagoi prapë dhe kundërshtimin e bazuar ia prezantoi fillimisht ministrit Shyqiri Bytyqi për të vazhduar pastaj me këtë angazhim dhe qëndrim të njëjtë edhe në takim me ministrin Yagcilar.

Në takimin me ministrin Bytyqi në ambientet e MASHT, kryetari i SBASHK-ut i paraqiti shqetësimet dhe kundërshtimet e bazuara të punëtorëve të arsimit nga shkaku i rangimit në tabelorin e këtij Projektligji për pagat duke argumentuar se punëtorët e arsimit nuk janë radhitur në vendin merituar në këtë tabelor, kurse menaxheri për financa dhe administratë, Ymer Ymeri i ofroi Ministrin Bytyri dhe kabinet të tij dokumente e argumente që argumentojnë këtë vlerësim të bazuar të SBASHK-ut.

“Projektligji për pagat bashkë me tabelorin, si i tillë, demanton deklaratimet e institucioneve të Kosovës se arsimin e kanë prioritet të parë ngase nga 73 grupet e pozitave në tabelor, punëtorët e arsimit janë ranguar në pozicionet 50, 51, 52 dhe 53 duke i barazuar kështu me profesionet për të cilat kërkohet vetëm arsimi elementar, gjegjësisht arsimimi i mesëm, është shprehur delegacioni i SBASHK-ut për ta kujtuar ministrin Bytyqi se edhe në kohën e Qeverisë Mustafa ministria e Administratës Publike kishte përgatitur një version shumë të ngjashëm me këtë tani të projektligjit për pagat duke bërë rangim nënçmues për punëtorët e arsimit dhe se pas kundërshtimit të bazuar të punëtorëve të arsimit ai Projektligj është tërhequr nga procedurat vijuese.

Ministri Bytyqi i ka deklaruar delegacionit të SBASHK-ut se ai dhe kabineti i tij do të angazhohen për zgjidhjen e drejtë të kësaj çështjeje dhe që sektori i arsimit të ketë vend merituar në këtë Projektligj.

SBASHK i trajnon udhëheqësit e sindikatave komunale për udhëheqje në arsim SBASHK vazhdon me aktivitetet në shërbim të arritjes së njohurive të reja

Në përpjekje që veprimtarët sindikalë të jenë sa më të përgatitur në përballje me sfidat e kohës, SBASHK-u ka organizuar trajnim 4 ditor me kryetarët e Kuvendeve të Sindikatave të SAF e SAM të komunave të Kosovës dhe të Universiteteve. Trajnimi temë kyçe ka udhëheqjen dhe planifikimin strategjik në arsim dhe është i licencuar nga MASHT.





Në mungesë të kryetarit në këtë aktivitet, pjesëmarrësit i ka përshëndetur këshilltari për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri duke përcjellë edhe mesazhin e kryetarit të SBASHK-ut drejtuar pjesëmarrësve që të jenë sa më të përkushtuar në këtë aktivitet me qëllim që të jenë të përgatitur në përballje me sfidat e kohës. Pas kësaj trajnerët Atdhe Hykollli e Besa Hoxha kanë filluar me shtjellimin e temave në kuadër të këtij trajnimi për të portretizuar profilin e drejtorit të shekullit XXI e për të vazhduar pastaj me bazat e menaxhimit dhe udhëheqjes, me rolin e menaxherit, aftësitë e tij, me nivelet e udhëheqjes,

cilat janë tipat e udhëheqësve, dallimi mes “bosëve” dhe udhëheqësve dhe çështje të rëndësishme që lidhen me udhëheqjen dhe planifikimin strategjik.



Trajnimi ka fituar në dinamikë përmes bashkëbisedës me pjesëmarrësit, të cilët kanë veçuar tiparet e tipave të udhëheqësve duke u munduar të vënë në pah të metat që ata nuk do t'i preferojnë nëse do të gjenden në pozicionin udhëheqës në shkollë apo sindikatë.

Edhe pjesa përmbyllëse e këtij trajnimi ishte mjaft dinamike sepse pjesëmarrësit duke pasur detyra konkrete kanë dëshmuar arritjet nga ky trajnim. Në përmbyllje të këtij aktiviteti mes pjesëmarrësve është gjendur edhe kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, i cili ka lavdëruar kryetarët e Kuvendeve të SAF e Sam për angazhimin e tyre në këtë trajnim dhe për punën e përkushtuar në terren në shërbim të anëtarësisë.

Për projektligjin për pagat takim edhe me Ministrin Yagcilar **SBASHK kundërshton me argumente dhe paralajmëron veprime sindikale**

Po të njëjtën ditë pas takimit me Ministrin Bytyqi, delegacioni i SBASHK-ut ka zhvilluar një

bashkëbisedë bukur të gjatë me Ministrin Yagcilar dhe temë kyçe ishte Projektligji për pagat, gjegjësisht radhitja e sektorit të arsimit në tabelorin e këtij Projektligji.



Pasi që janë takuar me Ministrin Bytyqi dhe i kanë shprehur pakënaqësinë dhe kundërshtimin lidhur me Projektligjin për pagat dhe radhitjen tepër të ulët në tabelën e rangimit, delegacioni i SBASHK-ut është takuar në pasditen e së hënës me Ministrin Mahir Yagcilar dhe anëtarët e kabinetit të tij. Ministri Yagcilar i ka deklaruar delegacionit të SBASHK-ut se jo vetëm Projektligji për pagat, por edhe dy ligje të

tjera ende janë në diskutim publik dhe se janë duke u zhvilluar takime e debate me palët e interesuara për të dëgjuar edhe qëndrimet e tyre konkrete. Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj ka kujtuar Ministrin Yagcilar se edhe në kohën e Qeverisë Mustafa SBASHK-u ka kundërshtuar Projektligjin për paga duke e parë si nënçmues e degradues për të punësuarit në sektorin e arsimit radhitjen tepër të ulët në tabelën e rangimit të profesioneve në bazë të koeficienteve. Kryetari i SBASHK-ut ka theksuar se pas reagimit të fuqishëm të SBASHK-ut Projektligji nuk ishte dërguar në Parlament dhe se kishte filluar dialogu për ndryshime meritore dhe se SBASHK në bashkëpunim me MASHT kishte dhënë propozim konkret e të bazuar për rangim meritore të punëtorëve të arsimit.

SBASHK-u ka shprehur kundërshtimin dhe reagimin e arsyesishëm në takim me Ministrin Yagcilar sepse edhe

në versionin e tanishëm të Projektligjit për paga, i cili vazhdon të jetë në diskutim publik, punëtorët e arsimit të Kosovës prapë janë radhitur në pozitë tepër të ulët, gjegjësisht në pozitë jo meritore. Kryetari i SBASHK-ut Jasharaj bashkë me menaxherin për financa Ymer Ymeri duke përcjellë qëndrimin e punëtorëve të arsimit janë shprehur të bindur se Ministri Yagcilar bashkë me Qeverinë e Kosovës do të marrin parasysh propozimin konkret e të bazuar në argumente të SBASHK-ut lidhur me këtë çështje tepër të ndjeshme dhe në versionin përfundimtar ky sektor i rëndësisë së veçantë do të jetë i ranguar në pozitë meritore. Në të kundërtën ky delegacion edhe në takimin me Ministrin Yagcilar ka përsëritur se SBASHK-u do të bëjë gjithë angazhimet që me dialog të përmirësohen lëshimet, duke mos përjashtuar as edhe një herë edhe masat dhe veprimet sindikale nëse pala tjetër nuk reflekton si duhet.

Vazhdon bashkëpunimi i suksesshëm i SBASHK-ut me GIZ-in

Organizim i suksesshëm i Konferencës së katërt të matematikës



Edhe me Konferencën e katërt të matematikës, organizuar në bashkëpunim me GIZ-in, SBASHK-u ka dëshmuar përkushtimin për të kontribuar në ngritjen e vazhdueshme të cilësisë dhe për një arsim edhe më të mirë në Kosovë. Temë kyçe kësaj ngjarje të rëndësishme ishte metodologjia e testit PISA dhe KANGAROO, si bazë për përpilimin e kërkesave për vlerësim dhe arritje të kompetencave të nxënësve.

Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj, në hapje të kësaj Konferencë që kishte bërë bashkë 120 punëtorë të arsimit nga e tërë Kosova, është shprehur se “edhe kjo ngjarje me rëndësi dëshmon se SBASHK-u vazhdon angazhimin dhe përkushtimin në realizimin e kërkesave të anëtarësisë dhe në frontin tjetër për ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në arsim”, për të apeluar te pjesëmarrësit që në këtë takim të rëndësishëm të sjellin ide të reja me qëllim të arritjeve edhe më të mëdha në sistemin arsimor.



Përfaqësuesja e GIZ , Rrezarta Zhinipotoku ka lavdëruar angazhimet dhe kontributin e SBASHK-ut në gjithë ngjarjet e rëndësishme për arsimin në Kosovë. Ajo është shprehur se GIZ bashkëpunon tani e sa vite me SBASHK-un sepse e ka parë se është partner i sinqertë strategjik dhe se është shembull fort i mirë i punës së përkushtuar.



Në pjesën e parë të Konferencës . Pleurat Rudi ka prezantuar temën "Metodologjia e ndërtimit të pyetjeve matematike te testit PISA dhe KANGAROO". Pas tij është prezantuar Arlinda Gashi-Bajgora me temën " Testi PISA- përparësi në ndërtim të pyetjeve në teste matematike. Pas kësaj pjesëmarrësit kanë shtruar pyetje rreth temave duke marrë përgjigje meritore nga të dy ligjëruesit.

Me fotografi e fjalë për një aktivitet të qëlluar të SBASHK-ut

Shumë nga pushuesit këto ditë pushimi i konsideruan si nga më të bukurat në jetën e tyre

Data 4 korrik ka shënuar përmbylljen e aktivitetit relaksues të SBASHK-ut dedikuar anëtarëve të vetë nga të gjitha komunat e Kosovës dhe Universitetet. Kjo traditë e mirë këtë vit ka filluar më 16 qershor kur pushues të përzgjedhur nga shkollat e Pejës, Klinës, Istogut, Deçanit, Junikut, Malishevës , Gjakovës dhe Rahovecit janë gjendur në ambientet e bukura të Kompleksit Turistik “Bonita” për pushimin meritor deri më 21 qershor. Për udhëtimin e mbarë nga Kosova , për akomodimin dhe që çdo gjë të jetë në rregull e në shërbim të një pushimi sa më të këndshëm të këtyre njerëzve të dijes janë kujdesur anëtarët e

Konferenca ka vazhduar punimet me prezantimet "Testi "Math kangaroo"- përparësi në ndërtim të pyetjeve në teste matematike" nga Valmir Krasniqi dhe "Vlerësimi për shkallë të Kurikulës, matja e rezultateve të kompetencës" nga Selim Mehmeti. Edhe pas këtyre dy prezantimeve pjesëmarrësit kanë shtruar një varg pyetjesh duke marrë përgjigje meritore. Pas kësaj pjesëmarrësit kanë vazhduar punën duke u ndarë në grupe, që po monitoroheshin nga Isuf Lajçi, Avdulla Krasniqi dhe Naim Bytyqi. Përfundimet nga puna e pjesëmarrësve në grupe janë prezantuar në pjesën përmbyllëse të kësaj konference.



Komisionit të emëruar nga organet udhëheqëse të SBASHK-ut.



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës



Ky aktivitet ka vazhduar pastaj me grupin e dytë, që buzë valëve të detit shqiptar janë gjendur nga 26 qershori. Ishin për të pushuar në këto ambiente relaksuese anëtarët e SBASHK-ut nga Prishtina, Podujeve, Universitetet, Lipjani, institucionet e kulturës dhe Qendrës së studentëve, Drenasi, Dragashi, Fusha e Kosovës, Kastrioti (Obiliqi), Prizreni dhe Mamusha.



Edhe këta pushues janë ndjerë mirë gjatë gjithë këtij pushimi dhe kanë lavdëruar SBASHK-un për këtë aktivitet. Ata në dy ditët e para më pak e kanë shijuar detin sepse shiu nuk po ndalej. Por, kjo nuk ua ka prishur disponimin. Ata të ulur në grupe zhvillnin biseda të lira duke kthyer shpesh kujtesën në vitet e

dekadat e shkuara. Po ashtu ata kanë bashkëbiseduar edhe për angazhimet, përkushtimin dhe sfidat në përpjekjet e përditshme për arsimimin dhe edukimin e brezave. Atmosfera është bërë edhe më e veçantë kur në “Bonita” kanë arritur edhe pushuesit e grupit të fundit të pushuesve nga Gjilani, Kamenica, Vitia, Mitrovica, Vushtrria, Skenderaj, Klllokoti, Leposaviqi, Shtimja, Ferizaj, Hani i Elezit, Kaçaniku e ndonjë komunë tjetër. Ata kanë shkëmbyer bisedat e para duke treguar të parët për momentet e pushimit e të dytët për rrugëtimin e bërë drejt Durrësit. Pas kësaj ata bashkërisht kanë drekuar dhe janë gjendur buzë valëve të detit të bukur shqiptar.



Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj përgëzon gjithë pushuesit për qëndrimin e tyre të dinjitetshëm dhe për prezantimin në pamjen më fisnike të personalitetit të mësuesit nga Kosova dhe falënderon në emër të tij e gjithë organeve udhëheqëse të SBASHK-ut Ymer Ymerin, Blendor Shatrin, Afërdina Ahmetin, Nezafete Jakupin, Rrezarta Bahtijarin ,Shqipe Kastratin, Sefedin Berishën ,Halime Ramën, Marigonë Bytyqin, Bajram Shalën, e Bahrie Ismailin për angazhimin maksimal që pushimet të kalojnë si është më së miri.

Për atmosferën e ditëve të pushimit më shumë se mijëra fjalë e fjali flasin fotografitë spontane nga ky aktivitet, një pjesë të të cilave po i publikojmë në kuadër të këtij shkrimi.

